

FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për përdoruesin

MANITOL

Tretësirë për perfuzion - 200 mg / ml (20%)

(Manitol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Manitol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Manitol
3. Si ta merrni Manitol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Manitol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË MANITOL DHE PËRSE PËRDORET

Manitoli është një diuretik osmotik. Edhe pse është një izomer i sorbitolit, ka vlerë energjetike më të vogël, meqenëse jashtëqitet në sasi më të madhe nga organizmi para se të zhvillohet metabolizmi i tij. Gjatë përdorimit parenteral, manitoli rrit presionin osmotik të plazmës dhe kështu e largon ujin nga indet e organizmit duke dhënë diurezë osmotike. Gjatë përdorimit si diuretik osmotik, manitoli administrohet në rrugë parenterale.

Manitol – tretësirë për perfuzion indikohet në:

- parandalimin dhe/ose mjekimin e oligurisë në të sëmurët me insuficiencë renale;
- uljen e presionit të rritur intrakranial dhe trajtimin e edemës së trurit;
- trajtimin afatshkurtër të glaukomës, sidomos për të ulur presionin intraokular përpara kirurgjisë oftalmike;
- trajtimin e helmimeve (rritet jashtëqitja e lëndëve helmuese).

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Manitol për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI MANITOL

Mos merrni Manitol në qoftë se keni:

- mbindjeshmëri ndaj lëndës aktive;
- kongjestion pulmonar ose edemë pulmonare;
- hemorragji intrakraniale (përveçse gjatë kraniotomisë);
- insuficiencë kardiake kongjестive;
- anuri;
- dehidratim të rëndë.

Tretësira e manitolit nuk duhet përzier asnjëherë me gjakun për transfuzion ose të futet në të njëjtin set në të cilin do të perfuzionohet gjaku, sepse eritrocitet aglutinohen.

Tregoni kujdes të veçantë me Manitol

Duhet ekzaminuar funksioni i sistemit renal dhe atij kardiovaskular.

Duhet treguar kujdes i veçantë në pacientët me insuficiencë renale të rëndë (në këta pacientë duhet administruar më parë një dozë provë për të kontrolluar funksionin e veshkave).

Gjatë perfuzionimit të tretësirës së manitolit është e nevojshme mbikqyrja e kujdesshme e bilancit të ujit, elektrolitëve dhe e shenjave jetësore, me qëllim që të parandalohet çrregullimi i bilancit të lëngjeve e elektrolitëve, përfshirë edhe mbingarkesën në qarkullim dhe dehidratimin e indeve.

Tretësira mund të kristalizojë gjatë ruajtjes, sidomos në temperatura të ulëta; kristalet duhen tretur, duke i ngrohur flakonet ose qeset para përdorimit.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Manitol.

Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me manitol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- ciklosporinë;
- digoksinë;
- litium.

Marrja e Manitol me ushqim dhe pije

Manitol merret si perfuzion kështu që nuk ndikon.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji

Kategoria C.

Për shkak të mungesës së informacioneve, duhet evituar përdorimi gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji.

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna.

3. SI TA MERRNI MANITOL

Rruga e administrimit: me perfuzionim në venë.

Doza është 1 - 2 g (5 - 10 ml tretësirë 20%) / kg peshë; në fillim përdoret një dozë provë me injektim të ngadalshëm në venë prej 200 mg / kg. Në edemat trunore përdoret një dozë prej 1 g / kg peshë, në trajtën e tretësirës 20 %.

Në qoftë se keni marrë më shumë Manitol

Në qoftë se keni marrë më shumë Manitol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Manitol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Efektet anësore që mund të ndodhin janë: reaksione mbindjeshmërie, të përziera, të vjella, dhimbje koke, marrje mendsh, takikardi, dhimbje gjoksi, hiponatremi, hipernatremi, hiperkalemi, ndjesi të ftohti, mbajtje urine, dehidrim, turbullim i të parit, konvulsione, tharje goje, etje, rinit, urtikarie, edemë pulmonare, hipotension ose hipertension, krampe, nekrozë e lëkurës, tromboflebit, çrregullime të bilancit të lëngjeve dhe elektrolitëve, nefrozë osmotike fokale.

Gjatë marrjes së dozave të larta mund të shfaqet acidozë.

Shumë rrallë mund të shfaqet insuficiencë kardiake kongjестive dhe insuficiencë renale akute.

5. SI TA RUANI MANITOL

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Manitol pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim!

Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!

Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

Tretësira mund të kristalizoje gjatë ruajtjes, sidomos në temperatura të ulëta; kristalet duhen tretur, duke i ngrohur flakonët ose qeset para përdorimit.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Manitol

Lënda vepruese është manitol.

Çdo flakon qelqi ose qese plastike 250 ml përmban 50 g manitol.

Çdo qese plastike 500 ml përmban 100 g manitol.

Përbërës tjetër është: ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Flakon qelqi ose qese plastike 250 ml.

Qese plastike 500 ml.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAH) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.

Rruga "Myslym Keta"

Tel.: 00 355 4 23 89 602

Tiranë - Shqipëri

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2012.